

Shqiponjat marrin KRAHE nga Roshi dhe Uzuni

nga Gent Mebelli
E enjte, 01 Prill 2021 00:00

Per here te pare ne histori Kombetarja KUQ e ZI zbret ne fushe ne një ndeshje zyrtare ndaj San Marinos.

San Marino, perfaqesuesja e vendit te fundit ne renditjen e FIFA-s nuk ka fituar asnjeherë në kualifikueset e një Boterori.



Me gjithë respektin, skuadra e San Marino-s është nie kundërshtar modest me nivel amator, portieri Benedettini dhe sulmuesi Nanni,

luajnë me klubin e Cesena-s në Serie C dhe janë lojtarët më të njohur të saj.

Per Shqipëri, pas humbjes ndaj Anglisë kjo është mundësia më e mirë për të mbyllur këtë fazë të parë kualifikuese me fitore. Në dy ndeshjet e para San Marino

është mundur 5-0 nga Anglia dhe 0-3 nga Hungaria ndërsa Kuqezinjtë triumfuan 1-0 në sfidën e parë në Andora dhe humbën pak ditë më pas 0-2 në kundërshtim me Anglisë

në Air Albania. Duket se udhëtimi për në San Marino do të jetë pak a shumë një shetitje për

Shqiponjat marrin KRAHE nga Roshi dhe Uzuni

nga Gent Mebelli
E enjte, 01 Prill 2021 00:00

Kombetaren qe patjeter duhet te marre tre pike.

Ne Stadio Olimpico San Marino nje stadium me kapacitet prej 6664 spektatoresh, skuadrat zbresin ne fushe me keto formacione:

SAN MARINO: Benedetini, Batistini, Fabri, Simoncini, Rosi, Palaci, Tomasini, Golinuçi, Mularoni, Nani, Berardi.
Trainer: Franco Varrella

SHQIPËRIA: Strakosha, Gjimshiti, Ajeti, Veseli, Hysaj, Lenjani, Bare, Laçi, Ramadani, Manaj, Broja.
Trainer: Edoardo Reja

Ne pjesen e pare Kuqezinjte zhvilluan nje loje te ngadalte, ne mesin e fushes mungon fantazia ne ndertimin e aksioneve, shpejtesia dhe saktesia ne pasimin e fundit

qe do ti dhuronte sulmuesve rastet per te rrezikuar porten e Benedetini-t. Ne sulm Manaj dhe Broja nuk kane forcen e duhur goditese, levizjet e tyre lexohen

dhe neutralizohen pa veshtiresi nga mbrojtja kundershitare.

Ne pjesen e dyte me futjen e Roshit dhe Uzunit,

Shqiponjat marrin KRAHE!

Shqiponjat marrin KRAHE nga Roshi dhe Uzuni

nga Gent Mebelli
E enjte, 01 Prill 2021 00:00

Loja tashme ka rritur te larte, freski dhe aksione te shpejta nga krahet. Shtohet presingu dhe rrezikshmeria perpara portes te San Marinos, por mungojne idete e qarta,

veprimet e kordinuara te lojtareve ne fushe. Me ne fund vjen minuta:

63' GOOOOOOOL! Rey Manaj nuk fal me koke brenda zones, mbas krosimit te Myrto Uzunit nga krahu i dhjathte i sulmit.

Shenon në momentin e duhur. Nga ky çast skuadra mori frymë lirisht dhe krijoj disa raste të arta për shënim, ku me pak fat Hysaj nuk do godiste vetem shtyllen!

Por fati do kthehej perseri ne minuten:

85' GOOOOOOOL! Myrto Uzuni prekje dhe devijim i lehte i topit te gjuajtur nga Frederik Veseli,

duke i buzeqeshur Uzuni-t.

Shqiperia ka marre tri pike te tjera ne kualifikimet per Kupa e Botes "Katar 2022" duke e mbyllur fazen e pare eliminatore ne vendin e trete me 6 pike,

perpara Polonine e cila u mposht 2-1 nga Anglia ne Wembley, Hungaria renditet e dyta me 7 pike, pas fitores 1-4 kunder Andores.

Shqiponjat marrin KRAHE nga Roshi dhe Uzuni

nga Gent Mebelli
E enjte, 01 Prill 2021 00:00

Ndeshjet e radhes se kombetares per kualifikueset e Boterorit do jene ne shtator, kunder Polonise, Hungarise dhe San Marinos.

Gent Mebelli